

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë e vlerësoj shumë kolegun parafolës, i cili, pas 5 orë diskutimesh në këtë sallë, solli disa elemente pozitive të aktit normativ dhe të ndryshimeve të buxhetit, pavarësisht relativizimit që i bëri mbështetjes që ky akt normativ u jep me ato buxhete, siç e tha me fjalët e tij popullore karakteristike, shtresave në nevojë dhe në veçanti pensionistëve. Në kohë krize nuk flitet për mrekulli dhe unë nuk kam dëgjuar asnjë koleg nga maxhoranca dhe asnjë ministër të flasë për mrekulli gjatë këtyre 5 orëve, por folën për mbështetjen e atyre që kanë më shumë nevojë, si në raport me ndihmën e drejtpërdrejtë, që është paketa e rezistencës dhe është një nga lajmet e mira të para të këtij kati normativ, ashtu edhe me ndihmën indirekte, që ka qenë një instrument i pandashëm i ndihmës direkte në të gjitha paketat në këto 3 vjet që kanë shoqëruar buxhetin e shtetit dhe familjet e çdo shqiptari, duke filluar nga tërmeti, pandemia dhe tani nga kjo krizë që është globale, nuk i janë shkëputur presionit familjar dhe buxhetit të shtetit.

Megjithatë, çfarë është bërë në këto 3 vjet, ka pasur një karakteristikë: mbështetja ka shkuar tek ata që kanë më shumë nevojë, te biznesi i vogël, si me ndihmën e drejtpërdrejtë, ashtu edhe me ndihmën indirekte. Nuk dua t'u kthehem paketave të mëparshme, por për të referuar ndihmën indirekte është paketa në mbështetje të energjisë, që jepet si një peshë që e mban buxheti i shtetit dhe jo familjet shqiptare. Ministrja tha pak më parë që 95% e familjeve shqiptare nuk do ta mbajnë këtë peshë, 96% e taksapaguesve që marrin deri në 40 mijë lekë pagë nuk mbajnë peshë në taksim, ashtu edhe 95% e biznesit të regjistruar në Shqipëri nuk paguan tatim-fitimi. Këto masa janë marrë edhe për të reduktuar sadopak buxhetin, që u tha

pak më parë dhe që është i vogël, por, mbi të gjitha, është një formë indirekte për të ndihmuar që familjet dhe biznesi i vogël të kursejnë më shumë dhe të rrisim më shumë konsumin.

Ky konsum ka sjell rritje pozitive, që nuk e mohojmë dot, sepse është 3,2% e parashikuar në fund të vitit dhe ka çdo tremujor që rritet. Këto shifra dhe fakte, që sado t'i përbaltim me fjalime me emocione apo pa emocione, janë aty prej disa kohësh dhe janë edhe si rezultat i një karakteristike të veçantë që paketat e këtyre 3 vjetëve kanë dhënë në ndihmë të buxhetit të shtetit efektivitet të masave. Nëse nuk do të ishin këto ndihma të drejtpërdrejta dhe indirekte, atëherë nuk do të kishte rritje ekonomike, sepse në rastin konkret, kjo rritje ekonomike, që e shpjegoi shumë qartë ministrja Ibrahimaj, vjen pikërisht edhe nga konsumi. Nuk dua të flas për rritjen e mëparshme, që erdhi nga mbështetja që i dhamë rindërtimit e më tej. Prandaj, të relativizosh këtë mbështetje, është politike, nuk është teknike, prandaj ne kemi detyrimin moral dhe ligjor të sqarojmë siç duhet qytetarët.

Cilat janë tre lajmet kryesore nga ky akt normativ? Përveç paketës së rezistencës, që pa dashur të hyj në përsëritje, ka një shtyllë të rëndësishme, pensionistët, pensioni i të cilëve, gati 687 mijë pensionistë, indeksohet për herë të parë në masë të rëndësishme me gati 9,5% në një vit, përtej faktit që do të kemi rritje të pagave për administratën, rritje të pagës minimale për të dytën herë këtë vit, përtej faktit që ka rritje të ndihmës ekonomike, dyfishim të paketave të ndihmave ekonomike, ne kemi edhe një lajm të dytë shumë të mirë, që vjen me rialokimet, që këtu nuk u përmendën, megjithëse kolegu Sinaj i tha pak më në detaje, në elemente shumë të rëndësishme për të zhvendosur aty ku investimet kapitale nuk kanë rezultuar siç duhet përgjatë gjithë vitit. Dua ta them këtu atë që diskutuam në Komisionin e Ekonomisë: realizimi i investimeve këtë vit ka qenë gati 71,5%.

Është logjike që në këtë akt të dytë normativ qeveria të shikojë dhe rialokojë aty ku ka më shumë nevojë dhe ku kanë ndodhur alokimet, sepse është shumë e rëndësishme të flitet për këtë lajm të dytë të mirë për alokimet. E para, në mbështetje të subvencioneve për bonusin e qirave të familjeve që akoma nuk kanë hyrë në shtëpitë e tyre, të dëmtuara nga tërmeti, kanë shkuar gati 1,2 miliardë lekë. E dyta, flasim për gati 4 miliardë lekë për zërin "Programi buxhetor transport rrugor" dhe zërin tjetër shumë të rëndësishëm "Për furnizimin me ujë dhe

kanalizimet”, që sigurisht do ta përmirësojnë më tepër cilësinë e shërbimit në këtë të fundit, për gati 38 miliardë lekë për arsimin parashkollor (këto janë brenda pushtetit vendor, por është shumë e rëndësishme që ky vendim merret duke rialokuar nga një zë te tjetri), për mbështetjen për mbrojtjen nga zjarri dhe shpenzime për transportin për nxënësit dhe mësuesit.

E treta, flasim për konsolidimin fiskal. Jemi akuzuar, sidomos në vitin 2021, për borxhin, për shtyrjen e konsolidimit fiskal me 1 vit, që e kemi aprovuar në këtë parlament. Unë e vlerësoj parafolësin, i cili e vlerësoi uljen e borxhit. Debatin për shifrën nuk e kemi këtu, por, mbi të gjitha, debati më i madh që kemi është: A po realizojmë ulje të deficitit buxhetor? Po. A po ulet borxhi publik? Po. Ky akt normativ e sjell dukshëm një element të tillë, duke e çuar në 71,1% borxhin të parashikuar në fund të vitit (sikurse e tha edhe ministrja Ibrahimaj, këto janë parashikime, por buxheti ka shumë pak gjasa të ndryshojë për më keq dhe unë jam e bindur se do të ndryshojë për më mirë), si dhe sjell uljen e deficitit buxhetor nga 5,4% në 4,5%.

Është shumë e nevojshme të flasim edhe me gjuhën e ndërkombëtarëve, sepse debatin në studiot televizive këtu ne mund ta bëjmë edhe pak kakofonik për dëgjuesit. Raportet ndërkombëtare për të disatën herë radhazi nuk e kanë ndryshuar vlerësimin për financat publike dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse flasim për 3 vjet. Vlerësimet që vijnë nga dy institucionet ndërkombëtare, si Standard and Poor’s dhe Moody’s, konfirmojnë vlerësimet si ekonomi e qëndrueshme. Ajo që ndodhi në vlerësimin më të fundit në korrik, është përsëri konfirmim i një politike buxhetore, e cila vjen në mbështetje të konsumit, të shtresave në nevojë, por, mbi të gjitha, të një rritjeje ekonomike, e cila vërtet mundet që në këtë moment të mos jetë ajo që do të dëshironte çdo familje. Nuk dua të përmend emra këtu, por dua të kundërshtoj disa kolegë parafolës.

Ne nuk krahasohemi me Kosovën, por ne duhet të bëjmë një diferencë shumë të madhe midis ndihmës në shumën 100 euro për një herë dhe një ndihme që do të qëndrojë aty disa vjet, sepse indeksimi i pensioneve nuk bëhet vetëm një herë, nuk e ka efektin një muaj. Edhe ndihma ekonomike nuk e ka efektin 1 muaj. Po, jemi të dy ekonomistë dhe e dimë shumë mirë çfarë do të thotë “one off”. Ajo për të cilën po flasim është: një ndihmë ekonomike që shkon në buxhetin familjar, por, mbi të gjitha, për indeksimin e pensioneve, që do ta ketë efektin disa

muaj, për të përballuar të paktën efektin e rritjes së çmimeve, e cila mund të vazhdojë më tej dhe do të riindeksohet përsëri, shpresojmë me efektin e duhur, duhet vlerësuar dhe krahasuar, se nuk duhet të krahasojmë vetëm një vlerë ekonomike në vlerë absolute, por edhe në kohë për të gjithë ata që marrin këtë përfitim.

Sigurisht, ne mund të flasim gjatë për buxhetin. Unë do të doja të flisja me gjuhë të thjeshtë, për t'u kuptuar nga qytetarët, por rritja ekonomike është fakt, ulja e deficitit dhe e borxhit është fakt. Vlerësimi për këtë akt normativ shumë të rëndësishëm në momentin që po ndërmerret në situatën ekonomike të vendit dhe për të gjitha masat që po merr qeveria, jo vetëm në raport me buxhetin, por për të vendosur zbatimin e ligjit, për të vendosur të drejtën e të gjitha ligjeve, të cilat gjejnë zbatim siç duhet, për të sjellë më tepër mirëqenie dhe jo vetëm në kohë krize, por përgjatë gjithë kohës, është domosdoshmëri dhe kjo vlen edhe për të ardhurat.

Shpresoj vërtet që Ministria e Financave të vijojë me strategjinë afatmesme të rritjes së të ardhurave, në mënyrë që rritja ekonomike, jo vetëm të jetë rezultat i situatës aktuale, por edhe e strukturuar dhe me një betejë të padiskutueshme me informalitetin që nuk e kemi fituar ende, i cili nuk ka ngjyrë, as PD dhe as PS, është aty dhe duhet ta luftojmë të gjithë. Faleminderit!